



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrim Evropian

Mbledhja nr. 89

Prishtinë, dt. 19.06.2024, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Rrezarta Krasniqi, Fjolla Ujkani, Fridon Lala, Agon Batusha, Alban Bajrami, Shqipe Isufi, Driton Hyseni, Blerta Deliu-Kodra dhe Time Kadrijaj.

Mungoi: Elmi Reçica.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Adelina Demolli.

Mbledhjen e kryesoi Rrezarta Krasniqi, kryetare e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportimi i z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog;
3. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2024-2028, i ftuar z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog;
4. Votimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-275 për rrugët dhe për amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Votimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës dhe për amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Votimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë dhe për amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Votimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe për amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Raportimi i z. Besnik Bislimi, zëvendëskryeministër i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog;

Kryetarja, tha se në mbledhjen e kaluar, për shkak të kohës së limituar që kishte në dispozicion zëvendëskryeministri, na është dashur që ta ndërprejmë raportimin dhe sot jemi këtu për të vazhduar raportimin. Por, fillimisht, tha se do vazhdojmë me Programin Kombëtar për Integrim Evropian, program ky i cili është dokumenti kryesor strategjik i Republikës së Kosovës për zbatimin e reformave për integrim në Bashkimin Evropian, për të vazhduar edhe me diskutimet që mund t'i kemi. Prandaj, ju lutem të na e elaboroni më shumë lidhur me përmbajtjen dhe obligimet të cilat derivojnë nga ky dokument për institucionet tona.

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, prezantoi listën e projektligjeve, që janë planifikuar në kuadër të këtij programi për vitin 2024, si masa legjislative, si dhe reformat në kuadër të tri blloqeve, duke përfshirë ato në bllokun e kriterëve politike, ekonomike dhe standardet evropiane. Te kriteret politike është fjala për legjislacionin dhe politikat kornizë për reformën e administratës publike, reduktimin e barrës administrative, vazhdimi i racionalizimit të agjencive, si dhe avancimi i bashkëpunimit rajonal dhe evropian, që përfshihet në kapitullin 31. Te kriteret ekonomike, zbatimi i strategjisë për menaxhimin e financave publike, zhvillimi i kornizës ligjore për financat publike, përfshirë edhe përmes ligjit të ri dhe legjislacionit dytësor, vazhdimi i luftimit të ekonomisë joformale. Ndërsa, te standardet evropiane, lista është më e gjatë dhe përfshin, duke filluar me lirinë e mallrave, lirinë e lëvizjes së punonjësve, prokurimin publik, politikat e transportit, politikat ekonomike monetare, e kështu me radhë.

Kryetarja, tha se të gjitha këto masa, shpresoj se do të gjejnë zbatim, në mënyrë që të avancojmë në rrugën tonë evropiane. Kosova tashmë është nën masa të BE-së, masa të cilat nuk janë të dëshirueshme, për asnjërin nga ne, pavarësisht pozitës tonë politike, si opozitë. Duke qenë se Lajçaku është në Kosovë, po marr shkas vetëm nga deklaratat e juaj e fundit, të cilën e bëtë po në këtë sallë, javën e kaluar, kur thatë se keni informacione se përmbajtja e raportit është pozitive dhe do të rekomandohet për heqjen e masave ndaj Kosovës. Deklarata, të cilën e kundërshtoi zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, i cili tha se nuk ka hapësirë dhe arsye për spekulime publike nga aktorë të ndryshëm. Si e keni parë këtë reagim ju?

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, tha pajtohem me këtë deklaratë të z.Stano, nuk ka hapësirë për spekulime, dhe unë nuk kam spekuluar, ka spekuluar dikush tjetër, që ka thënë se kam informacione se BE-ja nuk do t'i heqë masat.

Driton Hyseni, tha se sa i përket procesit të integritimit, në mbledhjen e kaluar që kishim, dëgjuam për shumë procese pozitive dhe të arritura të institucioneve tona në përmbushjen e obligimeve të tyre, po ashtu edhe nga raportet po shihet se kemi 72% përmbushje të obligimeve që kanë dalë nga ERA 2, përkundër një niveli shumë të ulët të zbatimit të masave nga ERA 1, me 45% të përmbushura. Kjo

përqindje ka mundur të ishte edhe me e lartë, sikurse ne si Kuvend të kishim kryer punën tonë, siç kërkohet dhe t'i kishim miratuar projektligjet brenda afateve e kushteve të parapara, e ku këtu opozita ka mundur të ketë rolin e tyre vendimtar, që kjo përqindje të ishte edhe më e lartë. Pyeti për procesin e përpilimit të masave, që bëhet në koordinim edhe me ndërkombëtarët, sa i përket proceseve integruese, kur institucionet e linjës marrin zotimet e tyre për zbatimin e një përqindjeje e pastaj zbatimi i tyre nuk është në atë nivelin e dëshirueshëm. Cilët janë faktorët të cilët po ndikojnë pastaj në mospërmbushjen e këtyre zotimeve, ashtu siç i kanë planifikuar? Siç e dimë, nga data 1 prill 2016, ka hyrë në fuqi MSA-ja, ku në atë kohë ka qenë e menduar që ky dokument të zbatohet plotësisht brenda një afati dhjetëvjeçar. Tani kemi për shqyrtim edhe Programin Kombëtar për Integrim Evropian, deri në vitin 2028. A është biseduar të kemi një zgjatje afati për zbatim apo do të ketë një evoluim të MSA-së, në vitin 2026, që pastaj të shihet se si do të vepohet, me qëllim që MSA-ja të jetë e përmbushur në tërësi? Sa i përket masave të vëna nga BE për Kosovën, tha se e dëgjuam prononcimin e z.Lajçak, i cili tha se është pro largimit të këtyre masave. Ky është një lajm shumë i mirë, sepse edhe një person i cili është i ngarkuar nga BE dhe po viziton Kosovën sot e ka të njohur faktin se institucionet e Kosovës kanë bërë maksimumin në shtrirjen e rendit dhe ligjit në territorin e Kosovës dhe masat e tilla nuk kanë qenë aspak me vend dhe nuk kanë qenë të nevojshme të aplikohen ndaj Kosovës. Prandaj, ajo që ne duhet të bëjmë si pozitë ashtu edhe opozitë, është të apelojmë që këto masa të hiqen sa më shpejt që është e mundur, sepse ato masa nuk i meriton Kosova.

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, tha se procesi i integritimit evropian nuk është proces vetëm i Qeverisë, por është proces i të gjitha institucioneve të Kosovës. Është përgjegjës kryesisht Qeveria dhe ministrinë e linjës, por kemi edhe agjencitë e pavarura, të cilat kanë një rol në këtë proces, por edhe Kuvendi i Kosovës, te pjesa e projektligjeve. Deri tani kemi pasur dy dokumente në proces të integritimit, siç janë ERA 1 dhe pastaj 2, si dhe PKZMSA-në, ndërsa tani jemi dakorduar me Bashkimin Evropian që të ecim vetëm më Programin Kombëtar për Integrim (PKIE). Fakti që ne jemi duke e zbatuar tani e tetë vite këto dokumente, pa pasur statusin e vendit kandidat, tregon që institucionet tona janë shumë më të përgatitura se ato të secilit vend të Ballkanit Perëndimor, në momentin kur ato e kanë marrë statusin e vendit kandidat. Kosova do të jetë e gatshme që menjëherë pasi të marrë statusin e vendit kandidat dhe vlerësimit të kapaciteteve tona përmes pyetësorit, të fillojë me negociimin e kapitujve të veçantë. Se si do të procedohet në vitin 2026, do të varet se sa shpejtë do të përfundojë vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve tona për të absorbuar programin për integrim, pas marrjes së statusit kandidat. Sa i përket përmbushjes së të gjitha zotimeve nga ana e institucioneve të linjës, tha se ka shumë faktorë që ndikojnë. Ky program dizajnohet në bashkëpunim me BE-në, duke caktuar se cilat veprime do zbatohen këtë vit e cilat viteve të tjera, por në ndërkohë mund të dalin veprime e ngjarje, të cilat një ministri të caktuar e nxjerrin nga korniza, siç ishte rasti me Ministrinë e Shëndetësisë, gjatë kohës së pandemisë, apo atë të Energjisë me krizën e energjisë, pastaj ndryshon edhe prioriteti brenda ministrisë. E dyta, çka ndodh, është se disa ministri gjatë ecjes e kuptojnë se ka nevojë për modifikim sesi do të ecin në një reformë të caktuar. Në disa raste të tjera, mund të ketë vonesa në dëgjime të caktuara në shqyrtime në komisione dhe tejkalohe afatet. Dhe po ashtu, ka disa ministri të cilat kanë jashtëzakonisht shumë masa, ku mund të ketë shpërputhje në mes të masave, të cilat ne i parashohim edhe kapacitetet e vet ministrisë.

Sa i përket masave, tha se nga fillimi ka qenë e qartë se secili shtet anëtar i Bashkimit Evropian, se vendosja e masave është e padrejtë, ka dhe të tjerë që mendojnë se ka shkelje ligjore brenda Bashkimit Evropian, për mënyrën sesi janë vendosur këto masa. Po ashtu, ka të tillë, të cilët kanë iniciuar masa për të vërtetuar ligjshmërinë e vendosjes së këtyre masave, siç është një ekspert shqiptar në Gjermani, që po merret me këtë procedurë.

Arsyeja pse i janë vendosur masat Kosovës është e lidhur me trazirat e datës 26 dhe 29 maj, për të cilat është thënë shumë herë se dihet origjina. Origjina e këtyre trazirave është në Beograd, por duke qenë se ato kanë ndodhur brenda territorit të Kosovës, masat i janë vendosur Republikës së Kosovës. Menjëherë është parë që masat janë joproporcionale. Nga Kosova kërkohet diçka që nuk ndikon asgjë në de-eskalim, si p.sh. në një kohë kur protestohet në Zveçan, kërkesë e BE-së ishte që të zhvendoset kryetari i Komunës në Leposaviq.

Masat kanë qenë të përkohshme dhe të kthyeshme, pas de-eskalimit e edhe atëherë kur është konstatuar dyanshëm me EULEX-in, se situata është e qetë. BE-ja ka hezitur t'i largojë masat, madje ka pasur ide që ato hiqen gradualisht, me idenë që masat të përdoren për të tërhequr kompromise tjera nga ana e Kosovës, jashtë asaj për çka janë vendosur masat.

Time Kadrijaj, tha se sa i përket procesit të integritetit, ne si parti çdoherë iu kemi përkrahur dhe kemi votuar si për ERA-n, ashtu edhe për Program Kombëtar për Integritet Evropian, e përsëri edhe sot do të votojmë pro, e gjithë kjo me qëllim të avancimit të rrugës sonë evropiane. Pyeti: A po kërkohet një konsensus i vendeve të BE-së për heqjen e masave? Ne kemi konsideruar që për shkak të rastit në Banjskë, sanksione të tilla e edhe më të ashpra është dashur t'i vendosen Serbisë, por ne nuk e kemi parë ndonjë veprim të BE-së, në raport me këtë. Ne ende nuk kemi një raport se çka ka ndodhur në Banjskë, përkundër që kemi mbajtur një seancë dhe kemi një rezolutë, me anë të të cilës kemi kërkuar që të bëhet një hulumtim ndërkombëtar, lidhur me këtë ngjarje. Ne si opozitë, tha kemi kërkuar, avokuar e lobuar, në çdo takim, me qëllim të heqjes së masave. Shpresoj se nuk do të kërkohet ndonjë koncesion tjetër, me qëllim të heqjes së masave, sepse sa herë që ndodhemi në një situatë të tillë, kërkohet ndonjë koncesion tjetër. Sa i përket projektligjeve, tha se kemi Projektligjin për Këshillin e Pavarur Prokurorial, si dhe Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave, për të cilët kemi pranuar shumë vërejte se nuk janë në përputhje me legjislacionin e BE-së. Ju si zëvendëskryeministër për Integritet Evropian, pse nuk ndërmerrni masa, që këto projektligje të mos sillen në komision, duke qenë se nuk janë në përputhje me legjislacionin të BE-së, rrjedhimisht të mos sillen as në seancë plenare për lexim të parë, e as të dytë. Pra, të mos trajtohen fare në komisione parlamentare, si të tilla. Pyeti: Cilat do të jenë veprimet e juaja, sepse atëherë ne po biem ndesh me Programin Kombëtar, ku njëri nga kriteret është përafrimi i të gjitha ligjeve me legjislacionin të BE-së?

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, sa i përket masave, tha se ka pasur në vazhdimësi, jo nga BE, por nga vendet anëtare, kërkesa që kanë shkuar përtej arsyes, përse janë vendosur masat, por që Kosova nuk ka pranuar të shantazhohet në këtë drejtim. Sa i përket përafritimit të projektligjeve me legjislacionin të BE-së, tha se Kosova nuk e ka statusin e vendit kandidat dhe s'i kërkohet të harmonizojë plotësisht legjislacionin e vet me atë të BE-së, por i kërkohet të përafrojë atë me legjislacionin të BE-së. Po ashtu, tha se në këtë fazë është e pamundur që Kosova të harmonizojë plotësisht legjislacionin e vet me atë të

BE-së, sepse ai legjislacion është për komplet një standard tjetër edhe të administratës publike, edhe sistemit gjyqësor. Ndoshta ka të drejtë edhe BE-ja, kur thotë se ky projektligj nuk është në harmoni të plotë me legjislacionin e BE-së, por nuk ka të drejtë kur kërkon që të bëhet në harmoni të plotë me legjislacionin e BE-së. Lidhur me Projektligjin për Këshillin e Pavarur të Mediave, tha se kam pasur një takim me delegacionin e zyrës së BE-së dhe i kam pyetur se cila pjesë e projektligjit nuk është në harmoni me legjislacionin e BE-së, ata nuk kanë pasur përgjigje. Problemi është që edhe delegacioni i BE-së në Kosovë, mbështetet pak a shumë në disa raportime që i bën dikush nga ne dhe pastaj vetëm merr dhe replikon të njëjtat diskutime, por pa u futur në detaje. Nuk është bërë asnjë shkelje as nga grupi punues, as nga ju si komision, nëse aprovoni një projektligji, i cili nuk është qind për qind në harmoni me legjislacionin e BE-së, sepse në disa fusha as edhe nuk ka standard të BE-së. Sa i përket portaleve online, tha se portalet online dikush i rregullon me ligj, dikush i lejon që ato vetë të rregullohen. Do të thotë, ka standarde të ndryshme. Ne pastaj, dhe ju si ligjvënës, vendosni se cili nga këto modele më së shumti i përshtatet realitetit tonë.

Fjolla Ujkani, lidhur me masat, njoftoi se para 15 minutave, përfaqësuesi i Lartë për Politikën e Jashtme ka rekomanduar që Kosovës t'i hiqen masat. Dhe dëshira e juaj besoj u plotësua, kryetare.

Blerta Deliu-Kodra, sa i përket masave për Kosovën, tha se tashmë dëmi Kosovës i është bërë, flas për 300 milionë euro vlerë të parave të BE-së, të cilat kanë qenë të destinuara për projekte kapitale, për mirëqenie të qytetarëve tanë, si dhe për një pengesë për investitorët potencialë. Sa i përket Serbisë, tha se Serbia ka qenë e tillë dhe me vite jemi përballur me një sjellje të tillë dhe me destruktivitetin e tyre. Për mua është shqetësuese se çfarë Kosove po duam, a e duam një Kosovë e cila mëton të jetë e izoluar dhe përjashtuar, apo investimi i Qeverisë duhet të jetë që Kosova të jetë e hapur, e integruar me partnerët dhe ne të përfitojmë.

Sa i përket opozitës, tha se opozita ka bërë punën e saj dhe ka marrë pjesë në votimin e të gjitha marrëveshjeve ndërkombëtare dhe po ashtu do të votojmë edhe sot për PKIE, sepse ne konsiderojmë se integrimi në Bashkimin Evropian duhet të jetë fundament i shtetit.

Sa i përket përafrimit të legjislacionit, tha se sa më i thellë të jetë përafrimi i legjislacionit, rruga për integrim do të jetë më e lehtë. Shtoi se nëse ju më thoni se keni pasur pyetje direkte për Komisionin Evropian, lidhur me KPM-në, unë ju them se drafti thotë se 10 nga 12 rekomandimet kryesore të KiE-së nuk janë trajtuar nga Komisioni për Media, që i bie 83% e tyre. Konsideroi që fundamenti i ynë është që të sigurojmë që mediat të jenë të pavarura në fushën e tyre, nëse nuk i inkorporojmë direktivat e Bashkimit Evropian në kohën kur Kosova po synon të jetë anëtare në Këshillin e Evropës, unë dyshoj që pengesat tona do të jenë të vazhdueshme, sepse nuk mund t'i izolojmë mediat dhe të vendosim ne se cilat audio-video duhet të postohen dhe Qeveria të jetë gardiani kryesor. Pyeti: A keni dëgjuar çfarë kanë thënë AGK-ja, shoqëria civile e Bashkimi Evropian, e për një ligj të tillë? Pra, duhet të ngrihet alarmi e të flitet pak më zëshëm, sepse fundi, dëmi është i Kosovës, i demokracisë në këtë vend dhe natyrisht shtu këtu sanksionet, njohjet e reja e anëtarësimin në organizata, po ashtu edhe gjendjen e rëndë ekonomiko- sociale në të cilën jemi, mendoj se duhet të bëhet më alarmante.

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, tha se masat i kanë sjellë dëme Kosovës, por vlera e dëmeve është vullnet i lirë, duke pasur parasysh se nuk ka asnjë studim që kuantifikon dëmin, por po ashtu nuk e dimë as se cili investitor potencial ka pasur në plan për ardhur të investojë në Kosovë, por e ka ndërruar vendimin si rezultat i vendosjes së masave. Pra, nuk mund të refuzoj shifrën që e nxorët ju, sepse nuk kam unë ndonjë shifër të saktë, por dëmi është bërë. Në situatën në të cilën kemi qenë, është dashur të marrim vendim ose të heqim dorë nga sovraniteti i veriut, ose për ta paguar një çmim. Ne kemi vendosur që të vendosim sovranitetin e vendit dhe ne mendojmë se ia ka vlejtur ky vendim i yni, sepse gjendja tani në veri është si të ndërtohet një shtet të ri nga fillimi.

Sa i përket anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, tha se ju e përmendët që kemi dështuar anëtarësimin në Këshill. Kosova nuk ka qenë në agjendë për anëtarësim, Kosova mund të ishte tërhequr nga agjenda, sikur dikush ta kishte vendosur në agjendë, por Kosova nuk ka qenë në agjendë për këtë takim. Kosova i ka kaluar të gjitha kriteret teknike për anëtarësim, ka mbetur vetëm votimi formal në Këshillin e Ministrave.

Sa i përket gjendjes ekonomike në Kosovë, statistikat tregojnë që niveli i punësimit në Kosovë është shumë më i madh se disa vite më parë. Statistikat tregojnë se numër i madh i bizneseve nxjerrin shpallje për të kërkuar punëtorë. Nuk ke mundur të paramendosh para tri viteve se Kosova do të vijë në atë pikë, që të diskutojë për të importuar fuqi punëtore nga jashtë.

Nuk ka migrim në Kosovë më shumë se në vendet e tjera, kur është bërë liberalizimi i vizave. Bizneset sot e kanë dyfish profitin më të madh se para tri viteve. Si mund të ketë krizë kur ka dyfishim të profitit?! Sa i përket KPM-së, tha se pajtohem me ju se sa më i afërt të jetë përafrimi, aq më e shkurtër është rruga drejt BE-së, por kjo tregon që aq më të ngritura janë institucionet tona, por ne nuk mund të themi se jemi me një veturë të vitit 2003 e të sillemi sikur vetura është e vitit 2023. Nuk mundemi, sepse administrata nuk mund të bëjë ligjet dhe të thotë se jemi vetëm dy vite larg BE-së. Sa i përket rekomandimeve të Këshillit të Evropës, tha se më është thënë nga anëtarët e Komisionit, se pjesa më e madhe e tyre është marrë parasysh. Por, vendimmarrës jeni ju, ata japin rekomandime e ju jeni vendimmarrës, të cilët vendosini se cilat rekomandime i merrni e cilat jo.

Blerta Deliu-Kodra, theksoi se ne kemi marrë disa obligime si shtet, kur kemi nënshkruar MSA-në, edhe për lirinë e medias, edhe për zhvillim ekonomik, dhe do kisha prit nga ju që, si zëvendëskryeministër, të bëni thirrje që projektligjet të cilat sillen në Kuvend, të jenë në harmoni me legjislacionin e BE-së.

Sa i përket statistikave të punësimit, tha se punësimi në vitin 2023, për dallim nga viti 2022, fuqia aktive është zvogëluar për 21.574 persona. Statistikat e migrimit, një anketë e Institutit GAP, e realizuar në vitin 2023, thotë se 28% e qytetarëve mbi moshën 18 vjeç planifikojnë të migrojnë në pjesën e parë të vitit 2024. E këtë e kemi ndjerë secili nga ne, sepse çdo ditë po i shohim qytetet e fshatrat të boshatisura, prandaj edhe kjo është arsyeja pse po ka konkurse më të shpeshta, sepse numri i qytetarëve është zvogëluar, e jo sepse qeveria e ka rritur punësimin. Sepse, kjo qeveri nuk ka ndikuar me politikat e saj për të krijuar një perspektivë për rininë e këtu lidhen edhe sanksionet e 300- milionëshit që ti na ke sjellë në raportin e KPSA-së, sepse investitorët potencialë, të cilët kishin për të investuar, do të mund të shkonin deri në miliarda, prandaj unë nuk e di cila është vlera e atyre investimeve që ata mund t'i sjellin

në Kosovë. Projektet kapitale po i referohem vitit 2014, ku kanë qenë 399 milionë, ndërsa në vitin 2023, projektet kapitale janë 349 milionë. Kjo flet se orientimi i Kosovës nuk është duke shkuar në drejtim të drejtë. Ndërsa, sa i përket Radojçiqit, ju duhet të mbani përgjegjësi e llogari, sepse bisedat e fundit telefonike nuk i kemi bërë ne. Pyeti: Çka do të ndodhte sikur dikush nga opozita të ishte dëgjuar duke biseduar me njeriun që është në listën e zezë të SHBA-Së dhe nuk po fals për një individ të vetëm, por për një person që përfaqëson fuqi politike, sepse është shefja e grupit tuaj parlamentar. Prandaj, kur përmendni emra, keni parasysh edhe ku keni shkuar ju, sepse zonja Kusari ka shkuar deri aty, sa ka arritur të potencojë edhe emrat e njerëzve ushtarë në bisedë me një kriminel të kërkuar nga ana e drejtësisë. Prandaj, përgjegjësinë duhet ta bartini mbi supe, z.Bislimi.

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, tha se punësimi është rritur për 65 mijë vende, që kanë kontratë dhe marrin pagë. Kjo nuk mund të ndryshojë. Cilëndo shifër që e merrni nga ASK, s'mund ta ndërrojë këtë të dhënë. Ndërsa, shifrat për migrimin do të dalin. I gjithë paniku që është përhapur ka dështuar, sepse nuk kanë dalë rinia, kanë dalë gjyshërit që po shkojnë po kujdesen për nipërit, por që nuk kanë qenë pjesë e fuqisë punëtore dhe nuk e kanë dëmtuar tregun e punës. Sa i përket vlerës së projekteve, tha se 300 milionë është vlera e projekteve, që nuk kanë mundur të prokurohen, por nuk janë zhdukur dhe do të kthehen.

Për projektet kapitale, tha se është e pasaktë, sepse janë më shumë se 700 milionë në vitin 2023 dhe është viti me projektet më të mëdha kapitale. Ne kemi diskutuar në vazhdimësi për nocionin e projekteve kapitale të qeverive paraprahe, sepse edhe kastrimi i qenve ka qenë projekt kapital i komunës x. Edhe projektet e punësimit i keni emërtuar projekte kapitale.

Blerta Deliu- Kodra, lidhur me projektet kapitale, tha se unë ju referova vetëm projekteve të Qeverisë jo edhe të komunave. E vërteta e madhe është që mungojnë investimet kapitale. Sa i përket migrimit, tha se e vërteta është që të gjitha grup-moshat janë duke e lëshuar Kosovën e jo vetëm gjyshet, siç po thoni ju. Është e vërtetë që Kosova me aferat që i ka pasur së fundmi, e ka zbehur perceptimin qytetar në raport me një qeverisje që e keni proklamuar dhe gjendja që është tani, nuk ju jep mundësi për një alternativë. Nuk po them që s'ka pasur migrim edhe në të kaluarën, por nuk mund të thoni që ne po mbjellim panik, sepse aq sa ju dhemb juve, duhet t'i dhemb secilit, sepse ju jeni nga një komunë e cila është boshatisur pothuaj tërësisht dhe ky duhet të jetë shqetësimi jonë.

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, tha se sa i përket kësaj zymtësie, që ju po prezantoni, mua nuk ma lejojnë numrat që ta shohë të tillë, duke qenë ekonomist numrat ma thonë të kundërtën, edhe as nuk dua ta shoh. Raportet e Bankës Botërore e Fondit Monetar, thonë që ka rritje ekonomike dhe Kosova është duke u zhvilluar më shpejt se rajoni.

Agon Batusha, tha se duhet të shqetësohemi edhe sikur vetëm një qytetar të lë vendin. Ne duhet të angazhohemi që të bëjmë më të mirën, si Qeveria, ashtu edhe ne si deputetë. Po ashtu, ne duhet të shohim edhe të marrim shembujt nga vendet e rajonit, përkundër që partitë opozitare kanë disa idolë në vendet e rajonit, të cilët nuk bëjnë as regjistrim të popullsisë, se do të dalin më keq se ne, përkundër që kanë gjendje ekonomike më të mirë se ne. Rol të rëndësishëm kanë edhe kryetarët e komunave, sepse janë të

parët, me të cilët kontaktin e parë e ka qytetari. Një pjesë e madhe e komunave udhëhiqet nga opozita, a ne të gjithë fajin ia hedhim Qeverisë.

Sa i përket investimeve kapitale, Qeveria e Kosovës e ka rritur buxhetin për investime kapitale. Pra, grantin qeveritar për komuna, në mënyrë që komunat të kenë më shumë mjete për të bërë investime kapitale. Ky ka qenë premtim i Lëvizjes Vetëvendosje në fushatë, e ky premtim është mbajtur.

Sa i përket masave të BE-së për Kosovën, ne nuk do të mund të dimë saktë se sa investitorë kanë pasur plan të vijnë, por ajo që ne ndoshta mund të bëjmë, është të shohim nga fondet IPA-s, se për një vit, sa para janë pezulluar. Statistikën time lidhur me këto fonde e kam dhënë në publik, dëm është sikur edhe një euro të humbet, por të mos flasim pa pasur shifra e të dhëna të sakta se ku janë ndërprerë.

Sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare, ato janë bllokuar nga ne, sepse për një vit e sa, opozita s'i ka votuar marrëveshjet ndërkombëtare, në vlerë prej 350 milionë eurosh. A është edhe ky një sinjal për investitorët e huaj që Kosova me vota të veta s'po lejon investim të qindra milion eurove me votat tona. Ajo që ne duhet të themi është që jemi i vetmi shtet që nuk kemi statusin e vendit kandidat, Bosnja, Moldavia, Gjeorgjia, ndërsa Kosova shtet në mes të Evropës, është pa status. Përkundër që Kosova është duke ecur me hapa shumë më të shpejt se krejt shtetet e rajonit, në implementim të politikave dhe përafrimit me ato politika, ky është një dëm që po i bëhet procesit të integritit. Kosova meriton statusin e shtetit kandidat.

Kosova ka hyrë në shumë programe të Bashkimit Evropian, kemi qenë në 4 programe, tanimë jemi në 12 programe të BE-së, ku përfitojnë rinia, bizneset e të tjerët.

Unë vlerësoj shumë mbështetjen e opozitës për këto dokumente, por në të njëjtën kohë kërkoj mbështetjen e tyre edhe për votim të projektligjeve, në mënyrë që të kemi një rritje edhe më të madhe të zbatimit të këtyre dokumenteve, që të ecim më shpejt në procesin e integritit.

Unë kam shqetësimet e mia, lidhur me atë sesi u mor qëndrimi për masa të BE-së me një njoftim të merren masa ndaj një shteti, ndërsa tani për t'i hequr këto masa duhet të marrin vendim të gjitha shtetet anëtare. Një shtet anëtar, i cili thotë se unë nuk po dua t'i heqë masat Kosovës, e bllokoi krejt procesin. Në vijim pyeti: Tek ato shtete që kanë qenë skeptike në heqjen e masave, a ka pasur lobim apo sqarim me to dhe a pritet ndonjë pengesë prej ndonjë shteti?

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, sqaroi se me masa janë prekur vetëm fondet e IPA-s 2022, të cilat nuk kanë mundur të kontraktohen. IPA 2023 është alokuar në masën siç ka qenë marrëveshja për energjinë, është suspenduar vetëm votimi për katër aplikimet tona në WBF. Lidhur me masat, tha se Kosovës kurrë nuk i është prezantuar baza ligjore e marrjes së atyre masave, por edhe kurrë nuk e kemi marrë një shpjegim të qartë se cila është procedura për heqjen e tyre. Nuk do të ketë votim për heqjen e tyre, por mund të ketë kundërshtim për heqjen e tyre nga një vend anëtar. Rrjedhimisht, nuk do të duhej të kishte asnjë vend anëtar, i cili ka kundërshtim. Edhe vendet të cilat kanë pasur hezitime, nuk kanë pasur hezitime që Kosova ka përmbushur ndonjë obligim, por ka pasur vende anëtare që kanë menduar që masat duhet të keqpërdoren për të nxjerrë koncesion shtesë prej Kosovës.

Shqipe Isufaj- Metaj, lidhur me heqjen e masave ndaj Kosovës, tha se përgjigjja nuk duhet të kërkohet nga Qeveria, por duhet të i duartrokasim që Qeveria e jonë, asnjë kompromis të dhimbshëm nuk e ka bërë kur ka qenë në pyetje vendosja e rendit dhe ligjit e mbrojtja e integritetit të vendit. Kur po ankohen për masat, kriteri i fundit ka qenë shpallja e zgjedhjeve në veri të vendit, organizimi i zgjedhjeve pa garantuar për ndonjë rezultat të zgjedhjeve. Po habitem me faktin se si janë në gjendje të bëjnë gjithë këto akuza në lidhje me masat, kur ne kemi masa nga vet opozita, që nuk ka marr pjesë në votime e të cilat kanë qenë të bllokuara në Kuvend.

Lidhur me investitorët e huaja, tha se ne kemi miratuar ligjin në nëntor të viti të kaluar për investimet strategjike, ndërsa opozita e ka dërguar në Gjykatë Kushtetuese. Agjencia për Përkrahjen e Ndërmarrjeve ka vështirësi në funksionim, jam habitur me rezultatin që kanë arritur, duke pas parasysh vështirësitë me të cilat ballafaqohen.

Sa i përket anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, tha se është e papranueshme se nuk është dashur që ai të jetë kriter për anëtarësim, pra ka qenë hera e parë që Komiteti i Ministrave nuk e respekton një rekomandim nga Asambleja Parlamentare.

Driton Hyseni, lidhur me masat e BE-së për Kosovën, tha se me kënaqësi ju njoftoi se Borrell sapo paska njoftuar se në raportin e tij ka rekomanduar heqjen e masave për Kosovën. Pra, edhe z.Borrell e ka parë si konstruktive punën e Qeverisë sonë në veri të vendit, prandaj edhe ka rekomanduar heqjen e masave për Kosovën. Edhe në takimet që kishim me shefin e Zyrës së BE-së, tha se na është thënë se asnjë cent, i cili ka qenë i dedikuar për Kosovën, qoftë në projektet të cilat financohen komplet nga BE, qoftë në projektet të cilat janë bashkëfinancim nuk do të preken, por do të pezullohen deri në heqjen e masave. Ideja e masave ka qenë që të pezullohen disa projekte të cilat ende nuk janë prokuruar. Projektet të cilat kanë qenë në zbatim, asnjë nga to nuk janë prekur. Prandaj, shumat të cilat u prezantuan sot këtu, nuk qëndrojnë sepse të gjitha ato mjete do të jenë në dispozicion të institucioneve të Kosovës sapo masat të hiqen.

Time Kadrijaj, lidhur me masat, tha se nga diskutimet e juaja po del se nga këto masa ne paskemi fituar. Pse atëherë BE-ja i paska vendosur këto masa, pse atëherë po bëhet tani ky lobim e avokim për heqjen e tyre, kur paskemi pasur vetëm fitime? Pra, ne duhet t'ju themi faleminderit për vendosjen e këtyre masave! Sa i përket migrimit, tha se në një takim që kishim me një ambasador në Komisionin për Punë të Jashtme, na ka njoftuar se mbi 100 mijë qytetarë janë duke pritur për vizë pune. Ndërsa, lidhur me marrëveshjet ndërkombëtare, ju jeni të fundit që duhet të na mbani shkollë për votimin e tyre, sepse ju jeni ata të cilët keni refuzuar edhe votimin e MSA-së. Tani nuk ka asnjë marrëveshje ndërkombëtare e cila nuk është votuar nga ne. Sa i përket koncesioneve, para se t'i dhurohet dhe të nënshkruhet për tokat e Manastirit të Deçanit, a është dashur të qartësohet pozicioni i Kosovës, që të ishte fituar anëtarësimi i Kosovës në Këshill të Evropës, përmes faljes së tokave të Manastirit të Deçanit? Ne edhe i dhuruam tokat e Manastirit të Deçanit, edhe nuk kemi anëtarësuar në Këshill të Evropës. Një veprim i pakoordinuar me aleatët tanë, po na sjell në vazhdimësi në pozicione të palakmueshme.

Driton Hyseni, tha se në asnjë moment nuk thashë se masat na kanë bërë mirë, por të pretendoni se na kanë dëmtuar me qindra miliona, nuk është e vërtetë. Sepse të gjitha mjetet që kanë qenë të alokuara do të kthehen pas heqjes së masave.

Agon Batusha, sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare, tha se janë 140 marrëveshje ndërkombëtare të miratuara në Kuvendin e Kosovës, janë vetëm dy të cilat nuk i ka miratuar Lëvizja Vetëvendosje, 'zajednicën' dhe demarkacionin. Sa i përket numrit të personave prej 100 mijë, që thate se kanë kërkuar për viza pune, një numër i madh i tyre janë të ripërsëritura dhe kjo deklaratë e juaja, se çka ka thënë ambasadori në takim, tregon që ti s'e kupton diplomacinë hiq. Je anëtare e Komisionit për Integrim dhe Punë të Jashtme, t'ju duhet të lobosh për heqjen e masave, pavarësisht a janë me vlerë 1 euro apo 1 milion euro dhe jo të mbesin barrë në kurrizin e Kosovës. Tanimë veriu i vendi është nën kontroll dhe nuk do të kenë mundësi tash dikush të shkojë të pijë raki me Radojçiqin, në vilat e tij.

Pas këtyre diskutimeve, kryetarja e hodhi në votim Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni, me tetë (8) vota për, miratoi Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2024-2028.

3. Votimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-275 për rrugët dhe për amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja tha se, siç e dini, diskutimet për këto projektligje kanë përfunduar në mbledhjen e kaluar.

Për shkak të mungesës së vendimmarrjes në mbledhjen e kaluar, ne sot këto projektligje i kemi për votim.

Hapi diskutimin dhe e hodhi në votim projektligjin, së bashku me amendamente.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni, me gjashtë (6) vota për, miratoi raportin me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-275 për rrugët dhe amendamentet e Komisionit funksional.

4. Votimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës dhe për amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja hapi diskutimin dhe e hodhi në votim projektligjin, së bashku me amendamente.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni me gjashtë (6) vota për, miratoi raportin me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-287 për Këshillin e Sigurisë të Republikës së Kosovës.

5. Votimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë dhe për amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja hapi diskutimin dhe e hodhi në votim projektligjin, së bashku me amendamente.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni, me gjashtë (6) vota për, miratoi raportin me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publikë.

6. Votimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe për amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja hapi diskutimin dhe e hodhi në votim projektligjin, së bashku me amendamente.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni, me gjashtë (6) vota për, miratoi raportin me rekomandime për Projektligjin nr.08/L-289 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

7. Të ndryshme

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Rrezarta Krasniqi